

GJYKATA E APELIT

Numri i rastit: PAKR 77/2017

Data: 14 nëntor 2017

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS në kolegjin e përbërë nga Gjyqtari i Gjykatës së Apelit, Driton Muharremi si kryetar i trupit gjykues , gjyqtarës së EULEX-it Anna Adamska-Gallant, si Gjyqtare raportuese dhe gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Abdullah Ahmeti, si anëtar i kolegjit me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore të EULEX-it Kerry Moyes si procesmbajtëse, në procedurën penale kundër;

M.S.;

V.T.;

M.S.

Pika 1- Keqpërdorimi i detyrës zyrtare në bashkëkryerje, në kundërshti me nenin 339 (1) dhe (2), në lidhje me nenin 23 të ish-Kodit Penal të Kosovës, që aktualisht penalizohet me nenin 422, në lidhje me nenin 31 të KPK-së të vitit 2013.

Pika 2- Marrja e ryshfetit në bashkëkryerje, në kundërshti me nenin 343 (1), në lidhje me nenin 23 të ish-KPK-së, që aktualisht penalizohet me nenin 428 në lidhje me nenin 31 të KPK-së të vitit 2013.

Pika 3- Ushtrimi i ndikimit në bashkëkryerje, në kundërshti me nenin 345 (1), në lidhje me nenin 23 të ish-KPK-së, që aktualisht penalizohet me nenin 431 (1) dhe nenin 31 të KPK-së të vitit 2013.

Pika 4- Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore në bashkëkryerje, në kundërshti me nenin 318 (1) dhe (4), në lidhje me nenin 31 të KPK-së të vitit 2013.

Pika 5- Dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale, në kundërshti me nenin 388 (1) të KPK-së të vitit 2013.

Pika 6- Dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale në kundërshti me nenin 388 (1) dhe (2) të KPK-së të vitit 2013.

Pika 7- Moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të tyre, në kundërshti me nenin 386 (1) nënparagrafin 9 të KPK-së të vitit 2013.

Pika 8- Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, në kundërshti me nenin 374 (1), në lidhje me nenin 120, item 38 të KPK-së të vitit 2013.

V.T.

Pika 4 - Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore në bashkëkryerje, në kundërshti me nenin 318 (1) dhe (4) në lidhje me nenin 31 të KPK-së të vitit 2013.

Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Ferizajit P. nr. 250/2013 të datës 6 tetor 2016 i pandehuri **M.S.** u dënua për:

Pika 1 – Keqpërdorimi Pozitës Zyrtare,

Pika 2 –Marrja e rryshfetit,

Pika 3 –Ushtrimi i Ndikimit,

Pika 6 - Dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale dhe

Pika 7 - Moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të tyre,

ahe për këto vepra penale atij iu shqiptua një dënim unik prej 7 viteve burgim, duke e llogaritur kohën e kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak dhe i pandehuri u përjashtua nga mbajtja e një pozite zyrtare për periudhën 5 vjeçare pas lirim të tij;

ai u lirua nga akuzat 4, 5 dhe 8 të Aktakuzës;

I pandehuri **V.T.** u lirua nga pika 4 e Aktakuzës.

Duke vendosur pas ankesave të mëposhtme kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Ferizajit P. nr. 250/2013 të datës 6 tetor 2016:

a. ankesa e parashtruar nga i pandehuri M.S. dhe avokati i tij mbrojtës A.R. më 26 janar 2017;

b. ankesa e paraqitur nga Prokurori Special më 26 janar 2017;

pas shqyrtimit të përgjigjes në ankesën e të pandehurit M.S. të paraqitur nga Prokurori Special më 9 shkurt 2017 dhe kërkesën e Prokurorit të Apelit të paraqitur më 27 shkurt 2017;

pas mbajtjes së seancës publike të Gjykatës së Apelit më 29 shtator 2017;

pas këshillimit dhe votimit më 14 nëntor 2017;

në pajtim me nenet 389, 390, 394, 398 dhe 402 (1) të Kodit të Procedurës Penale (KPP);

lëshon si në vijim

AKTVENDIM

- I. Pranohet ankesa e paraqitur nga i pandehuri M.S. dhe avokati i tij mbrojtës A.R. më 26 janar 2017;
- II. Anulohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Ferizajit P. nr. 250/2013 i datës 6 tetor dhe lënda kthehet në rigjykim;
- III. Hidhet poshtë ankesa e paraqitur nga Prokurori Special më 26 janar 2017.

ARSYETIMI

RRETHANAT RELEVANTE PROCEDURALE

1. Me 23 mars 2013, Prokurori ka lëshuar një Vendim mbi Fillimin e Hetimeve, i cili qe zgjeruar me 28 mars 2013 me rastin e lëshimit të Vendimit të Prokurorit mbi Zgjerimin e Hetimeve.
2. Me 11 shtator 2013, i pandehuri M.S. është arrestuar me 12 shtator 2013 dhe gjyqtari i procedurës paraprake ka urdhëruar paraburgim kundër tij. Ai u lëshua në arrest shtëpiak me 28 prill 2015. Ai ishte në arrest shtëpiak deri sa kjo masë u revokua me 6 tetor 2016 dhe iu shqiptua paraburgimi dhe që atëherë ai është në paraburgim.
3. Me 27 dhjetor 2013, Prokurori e ka parashtruar aktakuzën PPS Nr. 05/2012, duke i akuzuar zyrtarisht të pandehurit M.S., B.S.1., B.V., S.M., dhe R.A.1. Pas seancës fillestare të mbajtur me 10 janar dhe 10 shkurt 2014 të gjitha kërkesat për ta refuzuar ose hedhur poshtë aktakuzën dhe/ose provat, qenë refuzuar në shkallë të parë dhe në bazë të ankesës.
4. I pandehuri, A.M. nuk ka marrë pjesë në asnjë seancë dhe me 12 shkurt 2014 kryetari i trupit gjykues ka lëshuar një Urdhër Arresti vendor dhe ka aplikuar për një Urdhër Arresti Ndërkombëtar e cila qe lëshuar më pas. Rasti qe ndarë zyrtarisht dhe i ishte caktuar numri i ri i referencës PKR. nr. 193/15.

5. Shqyrtimi gjyqësor u mbajt me 19 dhe 30 maj, 2 dhe 12 qershor, 10 dhe 11 korrik, 4 dhe 25 gusht, 8, 16, 19 dhe 30 shtator, 13 dhe 28 tetor, 13, 14 dhe 27 nëntor, 5, 8 dhe 15 dhjetor 2014 dhe 16, 26 dhe 30 janar, 10, 23, 24, 25, 26 shkurt, 3 dhe 31 mars dhe 2, 21, 23, 27, 28, 29 prill, 2, 3, 9, 10, 11, 13, 22, 23 dhe 24 korrik, 2, 28, 29 shtator, 6, 13, 19 dhe 27 tetor, 16, 20, 23 dhe 24 nëntor, 7 dhe 8 dhjetor 2015 dhe 15 shkurt, 17, 18, 21 dhe 24 mars, 22, 25 dhe 26 prill, 21 korrik, 2 gusht, 5, 9 dhe 26 shtator, dhe 4 dhe 6 tetor 2016.
6. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 2 shkurt 2015 i pandehuri, R.A.1. hyri në një marrëveshje mbi pranimin e fajësisë me Prokurorin e PSRK-së dhe me 23 shkurt 2015 kryetari i trupit gjykues e ka ndarë rastin kundër tij. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 8 dhjetor 2014 avokatët e të pandehurve, B.V. dhe S.M., avokatët, I.H. dhe A.A., kanë theksuar se klientët e tyre kanë kërkuar që të lidhin një marrëveshje mbi pranimin e fajësisë në lidhje me akuzat. Me 15 dhjetor 2014 kryetari i trupit gjykues e ka lëshuar një aktvendim duke i liruuar që të dy të pandehurit nga paraburgimi në arrest shtëpiak. Pastaj, B.V. ishte arrestuar në Gjermani dhe ekstraduar në Kosovë dhe ishte dënuar me 4 gusht 2016. I pandehuri S.M. gjithashtu ishte arrestuar dhe me 8 nëntor 2016 dhe kryetari i trupit gjykues lëshoi një urdhër për ndarjen e lëndës.
7. Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të nxjerrë dhe të shpallur me 6 tetor 2016 , trupi gjykues e shpalli M.S. fajtor për:

Pika 1 aktakuzës

Sepse në qershor të vitit 2012, në Ferizaj, Kosovë dhe/ose gjetiu në Kosovë, i pandehuri M.S., si person zyrtar, gjegjësisht si toger në Policinë e Kosovës dhesi Shef i Njesisë kundër Trafikimit në Ferizaj, në bashkëkryerje me një person zyrtar tjetër të përcaktuar, po ashtu zyrtar i policisë, dhe me dashjen për të përfituar dobi pasurore të paligjshme, e kanë keqpërdorur pozitën zyrtare të tyre, sepse kanë fituar para nga X.B. dhe A.S., dhe pastaj nga anëtarët e tjerë të familjes së B.S.2. (gjegjësisht 4750 euro), duke u shkaktuar kështu dëm financiar këtyre individëve, në këmbim të premtimit për ta siguruar lirimin e B.S.2. nga paraburgimi ose të premtimit për tu siguruar që ai të mos e vuajë dënimin e tij. Këto veprime kanë përfshirë, mes tjerash, paraqitjet në familjen S. ku atyre u është thënë se të pandehurit do të kontaktonin me dëshmitarët në mënyrë që ata t'i ndryshonin deklaratat e tyre kundër B.S.2., do t'u jepnin dhurata prokurorëve të cilëve u ishte caktuar rasti i tij dhe do t'i hiqnin nga shkresat e lëndës disa prova që i ishin siguruar prokurorisë.

Kjo pikë e aktakuzës është cilësuar si keqpërdorim i detyrës zyrtare, në bashkëkryerje, në kundërshti me nenin 339, paragrafin 2, në lidhje me paragrafin 1, në lidhje me nenin 23 të ish-KPK-së, që aktualisht penalizohet me nenin 442, në lidhje me nenin 31 të KPK-së të vitit 2013.

Për këtë pikë të aktakuzës, trupi gjykues ia ka shqiptuar dënimin me tri vite burgim.

Pika 2 e aktakuzës

Sepse në qershor të vitit 2012, në Ferizaj, Kosovë dhe /ose gjetiu në Kosovë, i pandehuri M.S., si person zyrtar, gjegjësisht si toger në Policinë e Kosovës dhe si Shef i Njesisë kundër Trafikimit në Ferizaj, në bashkëkryerje me një person zyrtar tjetër të përcaktuar, po ashtu zyrtar i policisë, ka kërkuar dhe ka marrë dhuratë apo dobi tjetër për vetveten (gjegjësisht pagesë monetare në vlerë prej gjithsej 4750 eurove) për ta kryer, në kuadër të autorizimeve të tyre, një veprim zyrtar apo një veprim tjetër të cilin ata nuk është dashur ta kryejnë ose për të mos e kryer një veprim zyrtar apo veprim tjetër të cilin është dashur ose kanë mundur ta kryejnë ose për ta siguruar lirin e B.S.2. paraburgimi ose për tu siguruar që ai të mos dënohej dhe/ose për tu siguruar që ai të mos e vuante dënimin e tij. Këto veprime kanë përfshirë, mes tjerash, paraqitjet në familjen S. ku atyre u është thënë se të pandehurit do të kontaktonin me dëshmitarët në mënyrë që ata t'i ndryshonin deklaratat e tyre kundër B.S.2., do t'u jepnin dhurataprokurorëve të cilëve u ishte caktuar ka rastdhedo t'i hiqnin disa prova nga shkresat e lëndës që i ishin siguruar prokurorisë.

Kjo pikë e aktakuzës është klasifikuar si marrje e rryshfetit, në bashkëkryerje, në kundërshti me nenin 343, paragrafin 1, në lidhje me nenin 23 të ish-KPK-së, që aktualisht penalizohet me nenin 428 në lidhje me nenin 31 të KPK-së të vitit 2013.

Për këtë pikë të aktakuzës, trupi gjykues ia ka shqiptuar dënimin me pesë vite burgim.

Pika 3 e aktakuzës

Sepse në qershor të vitit 2012, në Ferizaj, Kosovë dhe/ose gjetiu në Kosovë, i pandehuri M.S., në bashkëkryerje me një person tjetër të përcaktuar, ka kërkuar dhe ka marrë ofertë (gjegjësisht pagesë monetare në vlerë prej përafërsisht 4750 eurosh) për dobi të paligjshme për vetveten në këmbim të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm nga ana e kryerësit në marrjen e një vendimi nga një person zyrtar ose për ta siguruar lirin e B.S.2. nga paraburgimi, ose për të siguruar që ai të mos dënohej dhe/ose për tu siguruar që ai të mos e vuante dënimin e tij, pavarësisht se a është ushtruar ndikim apo a ka shpënë ushtrimi i supozuar i ndikimit në rezultatin e synuar.

Kjo pikë e aktakuzës është klasifikuar si ushtrim i ndikimit, në bashkëkryerje, në kundërshti me nenin 345, paragrafin 1, në lidhje me nenin 23 të ish-KPK-së, që aktualisht penalizohet me nenin 431, paragrafin 1, në lidhje me nenin 31 të KPK-së të vitit 2013.

Për këtë pikë të aktakuzës, trupi gjykues i ka shqiptuar dënimin me dy vite burgim.

Pika 6 e aktakuzës

Sepse më datën 29 maj të vitit 2013, në Ferizaj, Kosovë ose gjetiu në Kosovë, i pandehuri M.S. është informuar që R.A.1. kishte shtënë në një veturë afër një restoranti që quhej *“Internacional”* dhe M.S. jo vetëm që nuk e ka raportuar këtë incident, por ka ndërhyrë në mënyrë aktive për ta (i) bindur viktimën (at) që të mos e raportonte incidentin në polici. Duke e bërë këtë, M.S. i ka ndihmuar R.A.1., si kryes i krimit (gjegjesisht, në kundërshti me nenin 365(1), “shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm”, dhe nenin 375(2), “përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”, të KPK-së të vitit 2013, të cilat janë vepra penale sipas Kapitullit XXX- Veprat penale të armëve të KPK-së të vitit 2013) që t’i shmangej zbulimit apo arrestimit dhe ka marrë hapa në drejtim të pengimit të arrestimit, kryerjes së tij apo dënimit të R.A.1., duke siguruar që R.A.1. të mos raportohej për një vepër penale që e kishte kryer.

Kjo pikë e aktakuzës është klasifikuar si dhënie e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale në kundërshti me nenin 388, paragrafët 1 dhe 2 të KPK-së të vitit 2013.

Për këtë pikë të aktakuzës, trupi gjykues i ka shqiptuar dënim me një vit burgim.

Pika 7 e aktakuzës

Sepse më datën 29 maj të vitit 2013, në Ferizaj, Kosovë ose gjetiu në Kosovë, i pandehuri M.S. është informuar se R.A.1. kishte shtënë në një veturë afër një restoranti që quhej *“Internacional”* dhe M.S. pastaj nuk e ka raportuar këtë incident, i cili përbën vepër penale (gjegjesisht, është në kundërshti me nenin 365(1), “Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm”, dhe nenin 375(2) “përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” të KPK-së të vitit 2013, të dyja vepra penale sipas Kapitullit XXX- Veprat Penale të armëve të KPK-së të vitit 2013).

Kjo pikë e aktakuzës është klasifikuar si moslajmërim i veprave penale apo kryesve të tyre në kundërshti me nenin 386, paragrafin 1, nënparagrafin 1.9 të KPK-së të vitit 2013.

Për këtë pikë të aktakuzës, trupi gjykues i ka shqiptuar dënim me një vit burgim.

Sipas nenit 80 (1) të KPK-së gjykata ia ka shqiptuar një dënim unik prej 7 (shtatë) viteve burgim.

Sipas nenit 83 (1) të KPK-së, koha që M.S. e ka kaluar në paraburgim është llogaritur në dënimin me burgim.

Sipas nenit 42, paragrafit 1, dhe nenit 65, paragrafit 1 të KPK-së, M.S. i ndalohet që të mbajë ndonjë pozitë zyrtare për një periudhë prej pesë viteve.

Sipas neneve 41 (1.3), 62 (2.2) dhe 64 (1) dhe (2) të KPRK-së M.S. është urdhëruar që t'i paguajë dëmshpërblim familjes S. për humbjen e 4750 eurove. M.S. është bashkërisht dhe ndaras përgjegjës me të bashkakuvarin B.S.1., i cili është deklaruar fajtor për kthimin e kësaj shume, e cila duhet të kompensohet deri më 31 dhjetor të vitit 2020.

Për pretendimet e tjera që i ka paraqitur familja S.s do të vendoset në procedurë civile të ndarë.

Pikat 4 dhe 5 të aktakuzës

Me të njëjtin aktgjykim trupi gjykues ka shpallur M.S. dhe V.T. të pafajshëm për pikën 4 (shmangien nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore, në bashkëkryerje, në kundërshti me nenin 318, paragrafët 1 dhe 4, në lidhje me nenin 31 të KPK-së të vitit 2013).

Trupi gjykues gjithashtu ka liruar M.S. nga pika 5 (Dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale, (Neni 388 paragrafi 1 i KPK-së).

Pika 8 e aktakuzës

M.S. është liruar nga pika e aktakuzës për mbajtje në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve në kundërshti me nenin 374 (1) të KPK-së, sepse ka rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale të tij. Vepra penale për të cilën është dënuar M.S. mbulohej nga *Ligji për Amnistinë* Nr. 04/L-209. Nuk ka pasur pretendime apo prova të ndonjë dhune apo kërcënimi me dhunë përmes përdorimit të armëve apo ndryshe nga M.S.

Shpenzimet e procedurës

Sipas nenit 450 të KPP-së shpenzimet e procedurës në shumë prej 500 eurove do të paguhet nga i pandehuri.

Në aktgjykimin me shkrim, trupi gjykues e ka urdhëruar edhe konfiskimin e përhershëm të municionit që është sekuestruar nga vendbanimi i të pandehurit.

8. Aktgjykimi i është dorëzuar Prokurorisë më 12 janar 2017 dhe një ankesë është parashtruar nga Prokurori Special më 26 janar 2017. Aktgjykimi i është dorëzuar të pandehurit M.S. më 18 janar

2017 dhe është paraqitur ankesë nga i pandehuri dhe avokatit të tij mbrojtës A.R. më 26 janar 2017. Ankesa e të pandehurit M.S. iu dorëzua Prokurorisë më 1 shkurt 2017 dhe një përgjigje në ankesë ishte paraqitur nga Prokurori Special më 9 shkurt 2017. Gjykata e Apelit nuk ka marrë përgjigje në ankesën e paraqitur nga Prokurori Special nga asnjëri i pandehur.

9. Rasti u transferua në Gjykatën e Apelit më 21 shkurt 2017. Më 27 shkurt 2017, Prokurori i Apelit i Shtetit paraqiti një kërkesë.
10. Seanca e Kolegjit të Gjykatës së Apelit u mbajt më 29 shtator 2017 në praninë e të pandehurit M.S. dhe avokatit të tij mbrojtës A.R., A.S. - avokati mbrojtës i të pandehurit V.T., të palës së dëmtuar B.S.2. dhe avokatit të tij mbrojtës B.S.3., dhe Prokurorit të Apelit Ewa Korpi.
11. Gjykata e Apelit shqyrtoi dhe votoi më 11 tetor dhe 14 nëntor 2017.

PARASHTRISAT E PALËVE

Ankesa e paraqitur nga i pandehuri M.S. dhe mbrojtësi i tij A.R.

12. Ankesa është ushtruar për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale; shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; vendimit për dënimin, sanksionin penal dhe kompensimin në shumën prej 4750 eurove.

Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale

13. Në ankesë theksohet se aktgjykimi përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 384 (1) pikës 1.12 në lidhje me nenin 370,(2),(3),(4)dhe(5)të KPP-së, sepse nuk e ka formën dhe përmbajtjen që çdo aktgjykim duhet ta ketë. Më konkretisht, në faqen e parë nuk është treguar nëse i pandehuri është i martuar, nëse është person familjar, kush janë anëtarët e familjes së tij, a ka fëmijë apo të çfarë moshe janë ata si dhe çfarë shkollimi ka e kështu me radhë. Në ankesë theksohet se në faqet nga 4 deri në 8 të aktgjykimit, në dispozitiv, i pandehuri shpallet fajtor për 8 vepra penale. Në dispozitiv nuk përcaktohen dënimet për secilën vepër penale veç e veç. Kah fundi i aktgjykimit, në fillim të paragrafit 929, i pandehuri shpallet fajtor për 5 vepra penale, ndërsa atij i shqiptohet një dënim unik me 7 vite burgim. Përveç kësaj, dispozitivi është kundërtshënës në vetvete, meqë aty nuk prezantohen arsyet për faktet vendimtare, ndërsa ato që prezantohen janë të paqarta dhe në kundërshti me përmbajtjen e provave. Krahas kësaj, në dispozitiv nuk saktësohet koha dhe vendi i kryerjes së veprat penale, ndërsa shumës prej 4750 eurove nganjëherë i referohet si shumë e përafërt.

14. Në ankesë pretendohet se aktgjykimi është kundërthënës dhe i paqartë në pjesën më të madhe. Një pjesë e madhe e tekstit përbëhet nga ekstraktet që janë kopjuar nga procesverbalet e seancave të shqyrtimit gjyqësor. Nuk ka analizë të besueshmërisë së deklaratave të dëshmitarëve apo provave të tjera materiale. Në veçanti, nuk pasqyrohet besueshmëria e deklaratave që i ka paraqitur i pandehuri.
15. Ankesa parashton se gjykata e shkallës së parë nuk ka vendosur në lidhje me zgjerimin e aktakuzës kundër të pandehurit në shqyrtimin gjyqësor (shkelja e nenit 384 (1.7) të KPP-së). Prandaj, aktgjykimi i ankimuar është i paplotë, i pasaktë dhe i paqëndrueshëm në vetvete dhe i pakuptueshëm, duke shkelur KPP-në.
16. Ankesa parashton se të drejtat e mbrojtjes ishin shkelur nga përjashtimi i avokatit mbrojtës A.I. nga Gjykata Themelore dhe se aktgjykimi nuk jep arsye të vlefshme për këtë vendim, i cili ka ndikuar në mbrojtjen e të pandehurit pasi A.I. ka qenë i angazhuar në këtë lëndë që nga fillimi i procedurës (shkelja e nenit 126 (1) të KPP - avokati mbrojtës si dëshmitar i privilegjuar; neni 56 – përjashtimi i mbrojtjes)
- Si rezultat, Gjykata ka shkelur të drejtat e mbrojtjes dhe kjo ka ndikuar ose ka mundur të ndikojë në marrjen e aktgjyqimit të ligjshëm dhe të drejtë. (Neni 384 (2.2) i KPP-së).

Shkelja substanciale e ligjit penal

17. Në ankesë theksohet se i pandehuri është dënuar për veprën penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, por veprimet e tij janë cilësuar sipas 2 dispozitave ligjore alternative: Neni 339 të Kodit të Përkohshëm Penal dhe neni 422 të Kodit Penal të tanishëm. Kodi i ri penal duhet të zbatohet vetëm nëse është më i favorshëm për të akuzuarin, çfarë nuk është e vërtetë në këtë rast, ndërsa cilësimi juridik për një vepër penale është nga dy kode penale. Kjo vlen edhe për dispozitat ligjore për veprat penale të marrjes së rryshfetit dhe ushtrimit të ndikimit. Pastaj, këto vepra penale janë vetëm një vepër penale në vazhdim, sepse janë kryer kundër të njëjtës viktimë, ndërsa objekti i veprave penale është i njëjti dhe me të njëjtat situata dhe marrëdhënie.

Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike

18. Në ankesë theksohet se, sa u përket veprave që kanë të bëjnë me B.S.2., dëshmia e tij dhe e të gjithë dëshmitarëve të prokurorisë që janë miq ose anëtarë të familjes S. janë krejtësisht të njëanshme dhe për qëllim kanë vetëm hakmarrjen kundër të pandehurit, prandaj nuk janë të besueshme. Përndryshe, ata nuk kanë ndonjë njohuri të drejtpërdrejtë se B.S.1. ka ndarë paratë

me M.S. apo a ka qenë i përfshirë në cilëndo vepër penale. Mbrojtja beson se dëshmia e B.S.2. dhe e të gjithë dëshmitarëve të tjerë duhet të shpallet e papranueshme.

19. Në ankesë hyhet në disa detaje përkitazi me dëshmitë e dëshmitarëve të prokurorisë dhe theksohet se deri në rastin që ka të bëjë me kutinë e parfumit, ka qenë B.S.1. ai që i ka marrë vetë paratë. Prandaj, shpjegimi logjik i kësaj është se B.S.1. nuk i ka dhënë para të pandehurit M.S. Në këtë rast të fundit, kur i pandehuri ka qenë i pranishëm, kjo nuk është bërë me kurrfarë qëllimi për ta përfshirë atë apo për ta bindur familjen e B.S.2. se i pandehuri M.S. po i merrte paratë. Pastaj, i pandehuri nuk ka pasur ndonjë thirrje telefonike me X.B., i cili i ka pasur një numër thirrjesh telefonike me B.S.1. Më në fund, B.S.1 nuk është pyetur asnjëherë nëse i ka ndarë paratë që i ka marrë nga familja S. me të pandehurin dhe asnjëherë nuk ka dhënë ndonjë detaj për këtë. Mund të përfundohet se të gjitha paratë i ka marrë B.S.1., i cili i ka mbajtur për vete.
20. Sa i përket incidentit në restorantin 'Internacional', provat që i kanë dhënë dëshmitarët nuk i mbështesin konstatimet për fajësinë. Në ankesë jepen disa detaje në lidhje me deklaratën e M.S. për ngjarjet në fjalë dhe përfundohet se në atë deklaratë paraqitet gjendja faktike reale. Kjo nuk është vlerësuar në aktgjykimin e kundërshtuar, prandaj gjendja faktike nuk është vërtetuar drejt apo plotësisht, në kundërshti me nenin 386.
21. Në ankesë po ashtu përfundohet se aktgjykimi e ka shkelur ligjin penal në dëm të të pandehurit, sepse i ka shkelur dispozitat esenciale të procedurës penale për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Gjithashtu është e paqartë cili ligj penal është zbatuar për veprat penale lidhur me pikat e aktakuzës 1,2 dhe 3. Avokati mbrojtës gjithashtu propozon që Gjykata e Apelit të refuzojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe ta kthejë lëndën në rigjykim.

Përgjigja e prokurorit special në ankesë

22. Prokurori special e ka paraqitur përgjigjen në ankesën e të pandehurit M.S. më 9 shkurt të vitit 2017.
23. Sa i përket parashtresës së mbrojtjes se aktgjykimi nuk është shkruar në përputhje me nenin 370 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori special pretendon se në aktgjykim janë të pranishme të gjitha informatat që kërkohen me këtë nen. Kushtet e nenit 370, paragrafit 3, përkitazi me të dhënat personale janë plotësuar mjaftueshëm për ta identifikuar të pandehurin, ndërsa tërësia e

tyre e tregon qartë identitetin unik të tij, prandaj nuk ka pasurshkelje esenciale të procedurës penale në këtë aspekt.

24. Prokurori special nuk pajtohet se trupi gjykuesi ka cilësuar gabimisht veprat penale. I pandehuri i ka kryer veprat penale në vitin 2012, kur në zbatim ka qenë kodi penal i mëparshëm, ndërsa kodi penal i ri ky hyrë në fuqi në janar të vitit 2013. Prandaj, në aktakuzë tregohen drejt të dyja nenet që i cilësojnë veprat penale sipas kodit penal të mëparshëm dhe sipas kodit penal të tanishëm. Pastaj, pothuajse nuk ka asnjë dallim midis ligjeve sa u përket përkufizimeve të veprave penale në këtë rast.
25. Sa i përket mospërfshirjes së aktakuzës së ndryshuar në aktgjykim, Gjykata Themelore nuk e ka trajtuar këtë çështje, sepse në korrik të vitit 2015 tashmë ishte marrë një vendim, me të cilin Gjykata Themelore e pati refuzuar kërkesën e prokurorisë për ta ndryshuar aktakuzën. Prandaj, nuk ka pasur kërkesë që kjo çështje të përfshihej në aktgjykim.
26. Sa i përket përjashtimit të mbrojtësit A.I., ai është përjashtuar sepse Gjykata Themelore ka treguar se ai do të thirrej si dëshmitar dhe se ai nuk mund të jetë edhe dëshmitar edhe mbrojtës sipas nenit 56, paragrafit 2 të Kodit të Procedurës Penale. Prokurori special pretendon se kjo ka qenë gjëja e vetme me vend që mund të bënte trupi gjykues në ato rrethana. Një mbrojtës mund të thirret si dëshmitar me kusht që kjo mos të ndikojë në ndonjë çështje konfidenciale. Përndryshe, kjo ka ndodhur në vitin 2014, që ka qenë herët në këtë rast. Mbrojtësi nuk ka dorëzuar ndonjë argument se i pandehuri është dëmtuar si rezultat i zëvendësimit të mbrojtësit, ndërsa në Kodin e Procedurës Penale nuk ka ndonjë kusht që këto detaje duhet të përfshihen në aktgjykim.
27. Prokurori special pretendon se mbrojtësi thjesht po mundohet ta kontestojë tërë rastin përsëri duke pretenduar se nuk është trajtuar besueshmëria e dëshmitarëve dhe se ata nuk kanë ofruar prova të mjaftueshme për t'i mbështetur dënimet. Përkundrazi, trupi gjykues i ka parë dhe i ka dëgjuar dëshmitarët qartë dhe e ka pasqyruar vlerësimin e vet për ta në aktgjykim.
28. Prokurori special pohon se nuk ka pasur mospërputhje të konsiderueshme apo cënuesë në deklaratat e dëshmitarëve të prokurorisë dhe jep një numër shembujsh për ta mbështetur këtë pretendim.
29. Prokurori special nuk pajtohet me pohimin e mbrojtjes se dëshmitarët nuk janë të besueshëm sepse janë të afërt me B.S.2., ndërsa thekson se tërë konsistenca e provave dhe provat

mbështetëse të gjitha e kanë vënë në pah fajësinë e të pandehurit përtej dyshimit të arsyeshëm. Provat e këtyre dëshmitarëve i janë dukur të besueshme trupit gjykues, ndërsa mbrojtësi nuk ka përmendur ndonjë fakt apo argument të ri në ankesë. Trupi gjykues po ashtu me të drejtë ka konstatuar se deklaratave individuale të dëshmitarëve të mbrojtjes dhe të të pandehurve u ka munguar besueshmëria.

30. Prokurori special nuk pajtohet as me pretendimin e mbrojtësit se nuk ka prova për të dëshmuar se i pandehuri ka marrë para, prandaj nuk është provuar bashkëkryerja me B.S.1. Kjo nuk është e saktë, ndërsa prova për këtë janë ofruar në mjaft hollësi në rastin e prokurorisë dhe janë reflektuar në aktgjykim.
31. Prokurori special pretendon se trupi gjykues nuk është mbështetur në marrëveshjen për pranimin e fajësisë së B.S.1. si pjesë e konstatimit të tij për fajësinë e M.S., siç pretendon mbrojtësi. Kjo është shprehur qartë në aktgjykim dhe, veç kësaj, M.S. është shpallur fajtor duke u mbështetur në dëshmitë e besueshme të dëshmitarëve të prokurorisë dhe provave mbështetëse, të cilat kanë treguar se të dy këta burra kanë punuar në mënyrë të bashkërenduar dhe kanë marrë para si pjesë e planit të tyre të përbashkët.
32. Sa i përket incidentit në restorantin 'Internacional', provat janë të qarta se M.S. është thirrur për ta ndihmuar mikun e tij R.A.1. pasi ka ndodhur e shtëna dhe se ai ka shkuar në vendin e ngjarjes për ta parandaluar raportimin e veprës penale dhe nuk e ka raportuar vetë atë.
33. Veç kësaj, mbrojtja e ka gabim kur deklaron se M.S. nuk mund të shpallet fajtor për krime të shumta. Provat e paraqitura tregojnë se veprat penale janë kryer kundër viktimave të shumta, prandaj neni 81 nuk zbatohet në këtë rast. Në këtë rast, elementet e nevojshme për kryerjen e secilit krim janë të ndryshme dhe kërkojnë sjellje të ndryshme-si të tilla ato janë menduar për të mbrojtur interesa publike të ndara. Prokurori special citon tri aktgjykime që e mbështesin këtë qëndrim. Përndryshe, Gjykata Themelore ka vendosur për këtë çështje në disa raste gjatë procedurës.
34. Më në fund, prokurori special nuk pajtohet me mbrojtësin në lidhje me dënimin e shqiptuar, ndërsa thekson se dënimi unik me 7 vite burgim është i drejtë. I pandehuri e ka keqpërdorur detyrën e tij të mirëbesimit për një kohë të gjatë dhe në raste të ndryshme dhe shkalla e dëmit që i është shkaktuar familjes S. dhe biznesit të saj është konsideruar si tejet e rëndë kundër viktimave të shumta të cenueshme. Dënimi po ashtu shërben si garanci e përgjithshme se korrupsioni nga zyrtarët e policisë dhe ata që janë në pozitë mirëbesimi nuk do të tolerohet dhe

do të rezultojë në pasoja të rënda. Megjithatë, trupi gjykues i ka marrë parasysh edhe faktorët lehtësues, të cilat kanë qenë se M.S. nuk ka pasur dosje kriminale të mëparshme, se ka pasur një histori të gjatë të punësimit dhe se sjellja kriminale e tij do të ndikonte negativisht në familjen e tij. Prokurori special konsideron se trupi gjykues, nëse asgjë tjetër, ka qenë bujar.

35. Sa i përket krahasimit me dënimin që e ka marrë B.S.1., prokurori special vëren se ka një numër dallimesh të dukshme midis këtyre dy burrave si individë dhe procedurës penale kundër tyre, duke përfshirë akuzat me të cilat ata janë përballur, dhe se këta faktorë janë arsye të ata janë trajtuar ndryshe.

36. Sa i përket urdhrit për dëmshpërblim, Prokurori special pretendon se Gjykata Themelore ka vlerësuar drejt se M.S. dhe B.S.1. duhet të jenë bashkërisht dhe veçmas përgjegjës në këto rrethana.

37. Veç kësaj, shpenzimet mund të ishin llogaritur si shumë më shumë se 500 euro, marrë parasysh faktin se janë dashur më shumë se dy vjet e gjysmë për tu gjykuar, se kanë qenë afro 40 dëshmitarë dhe se janë mbajtur 85 seanca të gjykimit. Prokurori special kërkon që ankesa të refuzohet.

Ankesa e paraqitur nga Prokurori Special

38. Prokurori special ka ushtruar ankesë kundër aktgjykimit më 26 janar të vitit 2017 në lidhje me pikat 4 dhe 5 të aktakuzës, për shkak të:

1. vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sipas nenit 383, paragrafit 1.3, në lidhje me nenin 386, paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPP-së,
2. shkeljes së ligjit penal, sipas nenit 383 paragrafit 2, në lidhje me nenin 385, paragrafin 1.1 të KPP-së, dhe
3. shkeljes së procedurës penale, sipas nenit 383, paragrafit 1.1, në lidhje me nenin 384, paragrafin 2.1 të KPP-së.

Në lidhje me pikën 8 të aktakuzës:

1. shkeljes së ligjit penal sipas nenit 383 paragrafit 2, në lidhje me nenin 385, paragrafin 1.1 të KPP-së,

Në lidhje me dënimin plotësues që është shqiptuar dhe shpenzimet e procedurës penale

1. vendimit të gabuar për sanksionet penale, sipas nenit 383,paragrafit 1.4,në lidhje me nenin 387, paragrafin 1 të KPP-së,
2. vendimit të gabuar për shpenzimet e procedurës penale, sipas nenit 383,paragrafit 1.4 të KPP-së në lidhje me nenin 387 paragrafin 4 të KPP-së.

Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike (Pikat 4 dhe 5):

39. Prokurori special pretendon se Gjykata Themelore e ka bazuar vendimin e saj në dy dëshmitarët kryesorë për këto pika: Zyrtarin N.S. dhe Zyrtarin S.O., dhe në veçanti në atë se zyrtari N.S. e kishte ndarë mendjen për gjobën para se të flisnin me të pandehurin M.S. dhe të dy zyrtarët i kanë besuar deklaratës që V.T. e ka dhënë për veturën në atë kohë. Përpjekjet e të pandehurit M.S. për ta bindur zyrtarin N.S. që të ndryshonte mendje sa i përket gjobës janë anashkaluar nga Gjykata Themelore, meqë konstatimi i saj ishte se ai dhe i pandehuri M.S. nuk kanë qenë mbresëlënës në dëshmitë e tyre në përgjithësi. Po ashtu, sjellja e paligjshme e zyrtarit N.S. në këtë incident nuk është karakterizuar plotësisht.
40. Pretendimi i prokurorisë ka qenë se kur V.T. ishte ndaluar nga dy zyrtarët policorë, ai e ka kërkuar ndihmën e të pandehurit M.S. për t'ia shqiptuar vetëm një gjobë simbolike dhe për t'iu shmangur pagesës së tarifave doganore dhe konfiskimit të veturës. Kjo qartësohet nga një shqyrtim dhe analizim i drejtë dhe i paanshëm i bisedave telefonike të përgjuara, të cilat janë prova objektive.
41. Prokurori special e përsërit tërë bisedën telefonike dhe i jep disa detaje se pse provave të këtyre dy zyrtarëve të policisë u mungon besueshmëria. Ai përfundon se, marrë parasysh veprimet e asaj dite, fjalët që janë thënë, dëshmitë e dëshmitarëve, thirrjen telefonike kritike dhe dosjen disiplinore të zyrtarit N.S., është e qartë se këta dy zyrtarë policorë nuk e kishin ndarë ende mendjen se çfarë gjobe duhej të shqiptonin para se të flisnin me të pandehurin M.S. Përkundrazi, ai ka ndikuar në ta në mënyrë të paligjshme, meqë ka vepruar për t'i ndihmuar mikut të tij që t'i shmangej pagesës së tarifave doganore. Në vend të kësaj, Gjykata Themelore thjesht ka përfunduar se ka qenë e detyruar t'ia jepte dobinë e dyshimit të pandehurve në pajtim me parimin *in dubio pro reo*, ndërsa ky është vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i fakteve.

Shkelja e ligjit penal (Pika 4)

42. Prokurori special pretendon se konstatimi i Gjykatës Themelore se nuk mund të ketë përgjegjësi penale për shkak të formulimit të dykuptimtë të nenit 318, paragrafit 1, është shkelje e ligjit penal. Qëllimi i ligjvënësve mund të kuptohet nga i tërë teksti i këtij neni.

Shkelja e procedurës penale (Pika 4)

43. Prokurori special po ashtu pretendon se Gjykata Themelore e ka shkelur Kodin e Procedurës Penale kur e ka refuzuar kërkesën e tij për ta ndryshuar aktakuzën për ta shtuar një vepër penale shtesë në lidhje me këtë incident sipas nenit 350 të KPP-së, gjegjësisht keqpërdorimin e detyrës zyrtare nga të pandehurit në bashkëkryerje (nenin 422 i KPK-së).

44. Kërkesa është bërë sepse provat që janë paraqitur gjatë gjykimit kanë treguar se gjendja faktike sa i përket incidentit ka ndryshuar. Bazuar në këto prova, prokurori special pretendon se është vërtetuar qartë se i pandehuri V.T. e ka kërkuar ndihmën e paligjshme të të pandehurit M.S. për t'iu shmangur pagesës së tarifave doganore. Prokurori special jep disa detaje sa u përket fakteve që janë bërë të ditura gjatë gjykimit dhe që e kanë nxitur që të bëjë kërkesë për ndryshimin e aktakuzës.

Shkelja e ligjit penal (Pika 8)

45. Prokurori special nuk pajtohet me Gjykatën Themelore se kjo vepër mbulohet nga Ligji për Amnistinë. Ky ligj i referohet vetëm akteve që janë kryer para datës 20 qershor të vitit 2013, sipas neneve 1 dhe 3, për t'i mbuluar veprat që kanë mbetur nga lufta, dhe nuk është menduar që t'i mbulojë veprat e paligjshme për një kohë të pakufizuar. Prandaj, ky ligj nuk vlen për mbajtjen në posedim, kontroll apo pronësi të armëve nga i pandehuri M.S. më 11 shtator të vitit 2013.

46. Pastaj, si zyrtar për zbatimin e ligjit, i pandehuri ka qenë mjaft i vetëdijshëm për ligjin në fuqi. As pretendimi i tij se municioni ka ardhur nga ditët ndërkombëtare të shenjëtarisë apo nga vendet e tjera legjitime nuk është relevant, sepse kjo nuk është mbrojtje ligjore, siç nuk është as fakti se ai nuk e ka përdorur apo nuk është kërcënuar se do ta përdorte municionin relevant për konstatimin e fajësisë. Relevante është vetëm mbajtja në posedim dhe municioni ishte gjetur në shtëpinë e tij gjatë zbatimit të dudur të Urdhrit për bastisje dhe sekuestrim.

Përcaktimi i sanksionit penal

47. Prokurori special pretendon se ka pasur vendim të gabuar për sanksionin penal sipas nenit 383, paragrafit 1.4 të Kodit të Procedurës Penale, në lidhje me nenin 387, paragrafin 1. Ai pretendon

se ndalimi për të qenë zyrtar i policisë për pesë vjet është krejtësisht jo adekuat për shkak të rrethanave të rastit. Neni 65 i Kodit Penal e kufizon ushtrimin e funksionit në shërbimin publik për 1 deri në 5 vjet pas vuajtjes së dënimit me burgim. Megjithatë, asgjë në këtë ligj nuk e pengon një kryes të shumëfishtë që të dënohet sipas veprës penale. Prokurori special pretendon se i pandehuri kurrë më nuk duhet të jetë i përfshirë në veprimtari policore, zbatim të ligjit apo çfarëdo aktiviteti tjetër që ka të bëjë me zbatimin e ligjit, kurrë më. Përderisa Kodi Penal nuk e lejon drejtpërsëdrejti ndonjë ndalesë të përjetshme, asgjë nuk e pengon Gjykatën e Apelit që të shqiptojë dënim në këtë aspekt që do të ishte dënim kuptimplotë dhe konsistent me qëllimin e shqiptimit të tij.

48. Veç kësaj, prokurori special vëren se në marrëveshjen e pranimit të fajësisë për B.S.1. – me të cilën është pajtuar Gjykata Themelore dhe të cilën e ka aprovuar, është thënë se atij i ndalohet që të jetë zyrtar policor për 20 vjet, pasi është konstatuar se nuk ka pasur asgjë në ligj që e ka parandaluar ndonjë konstatim apo marrëveshje të tillë.

49. Kur e ka marrë vendimin për ndalim, Gjykata Themelore nuk i ka marrë parasysh disa faktorë rëndues sipas nenit 74 të Kodit Penal, veçanërisht shkallën e lartë të pjesëmarrjes së të pandehurit, shkallën e lartë të dashjes dhe paramendimit të tij, viktimat e shumta dhe faktin se ato kanë qenë veçanërisht të pambrojtura dhe të cenueshme. Në vend të kësaj, Gjykata Themelore i ka marrë parasysh dhe i ka stërtheksuar rrethanat lehtësuese dhe veçanërisht ndikimin në familjen e tij.

50. Prokurori special pretendon se në rrethanat e tij, sjelljen apo veprën nuk ka pothuajse asnjë cilësi shfajësuese apo zbutëse dhe kërkon nga Gjykata e Apelit që ta anulojë vendimin e Gjykatës Themelore sa i përket ndalimit të të pandehurit për të qenë zyrtar policor për vetëm 5 vjet dhe ta shtojë numrin e viteve siç duhet.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës

51. Më në fund, prokurori special pretendon se vendimi i Gjykatës Themelore për çështjen e shpenzimeve ka qenë jo adekuat në ato rrethana. Shuma prej 500 eurove nuk e reflekton këtë rast, i cili ka rezultuar në një gjykim të ndërlikuar dhe të gjatë. Nga Gjykata e Apelit kërkohet që ta vlerësojë një shifër më reale.

52. Gjykata Themelore po ashtu e ka emëruar mbrojtësin e të pandehurit M.S. *sipas detyrës zyrtare*. Megjithatë, nuk janë ndjekur procedurat e kërkuara, pasi që nuk është konsultuar Zyra për

Ndihmë Juridike dhe nuk është paraqitur asnjë kërkesë as nga i pandehuri e as nga mbrojtësi i tij, në mënyrë që mbrojtësi i paguar nga shteti të sigurohej në mënyrë të ligjshme. I pandehuri nuk kualifikohet për të shpenzuar para të shtetit në emër të tij dhe për ta mbrojtur atë për kallëzimet penale kundër tij.

Përfundim

53. Prokurori special kërkon që Gjykata e Apelit të anulojë përfundimin e Gjykatës Themelore dhe të konstatojë se të pandehurit M.S. dhe V.T. të dy janë fajtorë për Pikën 4 të Aktakuzës dhe të shpallin të pandehurin M.S. gjithashtu fajtor për Pikat 5 dhe 8 të Aktakuzës.
54. Prokurori Special gjithashtu kërkon që, përveç kësaj ose në mënyrë alternative, Gjykata e Apelit ta dënojë të pandehurin M.S. në bashkëkryerje me të pandehurin V.T. për veprën penale të Keqpërdorimit të Pozitës Zyrtare ose Autoritetit në kundërshtim me nenin 422 të Kodit Penal të Kosovës.
55. Prokuroria kërkon gjithashtu që Gjykata e Apelit ta anulojë vendimin e Gjykatës Themelore në lidhje me shpenzimet dhe t'i vlerësojë ato si duhet dhe që i pandehuri të urdhërohet t'i kompensojë shpenzimet për tarifatat e mbrojtësit të tij të caktuar *sipas detyrës zyrtare*.
56. Gjykata e Apelit nuk ka marrë përgjigje nga asnjëri i pandehur në ankesën e ushtruar nga prokurori i shtetit.

Kërkesa e parashtruar nga Prokurorja e Apelit

57. Prokurorja e Apelit pajtohet plotësisht me argumentet që i ka paraqitur Prokurori Special në parashtrësat e tij dhe i propozon Gjykatës së Apelit që ta aprovojë ankesën e prokurorit special dhe ta refuzojë ankesën e ushtruar në emër të të pandehurit si të pabazuar.

Deklaratat e bëra gjatë seancës së Gjykatës së Apelit të mbajtur me 11 tetor 2017

58. Prokurorja e Apelit në parim mbështeti ankesën e Prokurores dhe qëndrimin e paraqitur në parashtrësën e saj me shkrim. Më tej, ajo deklaroi se në lidhje me pikën 5, që është vepra penale e Dhënies së ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale, ajo vuri në dukje se kjo është e ndaluar nga ndjekja penale për shkak të parashkrimit i cili ka skaduar më 28 maj 2015. Prokurorja e Apelit i është referuar ankesës së Prokurorit të PSRK-së në këtë pikë dhe ka deklaruar se vepra penale duhet të ri-cilësohet si vepër penale e keqpërdorimit të pozitës zyrtare, pasi që të gjitha elementet e kërkuara për këtë vepër penale janë plotësuar. Prokurorja e Apelit i ka propozuar

Gjykatës së Apelit që të miratojë ankesën e Prokurorit të PSRK-së dhe të ndryshojë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Ferizajt dhe të dënojë M.S. për veprat penale nën Pikat 4 dhe 8 dhe të ricilësojë veprën penale sipas pikës 5, si dhe t'i shqiptojë të pandehurit një dënim plotësues. Prokurorja e Apelit gjithashtu i ka propozuar Gjykatës së Apelit që të bëjë një vlerësim të duhur të shpenzimeve të procedurës.

59. Lidhur me V.T., Prokurorja e Apelit i ka propozuar Gjykatës së Apelit që ta dënojë atë për Pikën 4, dhe ka argumentuar se për ta bërë këtë nuk kërkohet përsëritja e provave ose marrja e provave të reja, pasi që dënimi mund të bazohet në meritat ekzistuese të rastit. Për më tepër, Gjykata e Apelit është në të njëjtin pozitë siç ka qenë edhe Gjykata Themelore kështu që mund ta ndryshojë Aktgjykimin dhe të mos e dërgojë çështjen për rigjykim.
60. Për të mbështetur qëndrimin e saj për të mos e dërguar çështjen për rigjykim, Prokurorja e Apelit iu ka referuar Aktgjykimin të Gjykatës Supreme të datës 25 nëntor 2015 në lëndën 7/2015 dhe Numër PA 2 KZ 2. Prokurorja e Apelit theksoi përsëri se nëse vendimi është që të anulohet Aktgjykimin dhe çështja të kthehet për rigjykim, Gjykata e Apelit duhet gjithashtu të arsyetojë se pse nuk ishte e mundur që të vazhdohej siç parashihet në nenin 403 të KPP-së, pasi që vendimi për të dërguar një lëndë për rigjykim duhet vetëm përjashtimisht të merret.
61. Gjyqtarja raportuese e ka pyetur Prokuroren e Apelit nëse ka pasur ndonjë kërkesë gjatë shqyrtimit gjyqësor për t'ia dhënë statusin e dëshmitarit bashkëpunues B.S.1., megjithatë Prokurorja e Apelit ka deklaruar se nuk e dinte.
62. Mbrojtësi B.S.3., në emër të palës së dëmtuar B.S.2., ka deklaruar se në lidhje me pikat të cilat janë të lidhura me palën e dëmtuar - Pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 - ata u pajtuan me ankesën e Prokurorit. B.S.3. kërkoi që ankesa e Prokurorisë të vërtetohet dhe ankesa e mbrojtjes të refuzohet si e pabazuar pasi që nuk ka shkelje esenciale gjatë gjithë procedurës ose në Aktgjykim. B.S.2., në përgjigje të pyetjes së kryetarit të trupit gjykues, deklaroi se qëndron pranë asaj që ka thënë përfaqësuesi i tij.
63. Avokati mbrojtës A.S. në emër të të pandehurit V.T. deklaroi se ishin të kënaqur me vendimin e Gjykatës dhe se veprimet e të pandehurit ishin me natyrë të vogël administrative. Më tej, Aktakuza ishte parashtruar dy muaj pasi që pagesat doganore ishin paguar për këtë veturë dhe dëgjimi fillestar ishte një vit pas pagesës. Mbrojtësi deklaroi se të drejtat e njeriut të të pandehurit ishin shkelur nga ai duke u thirrur për të marrë pjesë në 120 seanca gjyqësore kur vepra e tij penale nuk kishte të bënte fare me familjen S. Kjo shkaktoi dëm potencial në vlerë prej

2,500 eurove dhe kostoja e mbrojtjes së tij ishte 12,000 euro. Ai i propozoi Gjykatës së Apelit që ta vërtetojë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore pasi që është i lidhur me klientin e tij.

64. Avokati mbrojtës A.R. në emër të të pandehurit M.S. deklaroi se qëndron plotësisht pranë pretendimeve në ankesë lidhur me shkeljet thelbësore të ligjit penal dhe ligjit të procedurës penale në dëm të të pandehurit dhe në lidhje me vendimin për dënimin. Ai deklaroi se dihet se aktgjykimi është akti më i rëndësishëm në procedurën penale dhe se neni 370 paragrafi 4 i KPP-së përcakton përmbajtjen dhe mënyrën e aktgjykimit, ndërsa pjesa më e rëndësishme e aktgjykimit është dispozitivi. Avokati mbrojtës deklaroi se aktgjykimi nuk është ashtu siç duhet të jetë sipas këtyre dispozitave dhe se kjo është në kundërshtim me nenin 384 dhe 370 të KPP-së. Më tej, neni 33 paragrafi 4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se të pandehurit mund t'i shqiptohen vetëm ato dënime që janë të zbatueshme në kohën kur është kryer vepra, me përjashtim të rastit kur ligji që është më i favorshëm mund të aplikohet për të pandehurin. Në Aktgjykim lidhur me veprat penale në Pikat 1, 2 dhe 3, veprimet inkriminuese të të pandehurit janë paraqitur me dy kualifikime ligjore alternative të dënimit. Këto kualifikime të veprave penale nuk mund të qëndrojnë pasi që kjo shkel parimin kushtetues të ligjshmërisë dhe është shkelje e nenit 384 të KPP-së. Në rast të dykuptimësisë, interpretimi i dispozitave ligjore do të shkojë në favor të të pandehurit, në përputhje me nenet 2 dhe 3 të KPP-së. Avokati mbrojtës deklaroi se në dispozitiv të aktgjykimit, i pandehuri është shpallur fajtor për të gjitha 8 pikat, dhe në dispozitiv nuk ka asgjë për dënimin. Arsyetimi fillon menjëherë dhe aktgjykimi merret me rrethanat e çështjes deri në faqen 233. Pastaj në faqen 238, Gjykata shqipton dënimin vetëm për pesë vepra penale dhe e liron të pandehurin nga tri vepra penale. Ligji parasheh që ndëshkimi të tregohet në dispozitivin e aktgjykimit dhe prandaj sipas mendimit të tij aktgjykimi duhet të anulohet. Avokati mbrojtës deklaroi se në lidhje me shumën prej 4.750 euro, nuk ka dëshmi nga asnjë dëshmitar që deklaron se ai apo ajo i ka dhënë para M.S., dhe nuk ka dëshmi se ai ka kërkuar ose ka marrë ndonjë shumë nga askush. Ai përfundoi se shqyrtimi gjyqësor zgjati pothuajse tre vjet, dhe disa prej tyre kanë të bëjnë me ballafaqimin me fajësinë apo pafajësinë e B.S.2. lidhur me veprën penale të trafikimit të qenieve njerëzore. I pandehuri ka qenë në paraburgim për 4 vjet e 18 ditë dhe në arrest shtëpiak për 2 vjet. Kur u shpall Aktgjykimi, prapë u urdhërua paraburgimi i tij me arsyetimin se ai mund të ikë. Avokati mbrojtës kërkoi që Gjykata e Apelit të ndërpresë paraburgimin e tij dhe ta kthejë lëndën në rigjykim.

65. I pandehuri M.S. deklaroi se qëndron pranë deklaratës së mbrojtësit të tij. Ai më tej deklaroi se është shumë i pafajshëm dhe se çfarë i ka ndodhur atij ishte hakmarrja sepse ai e kishte arrestuar B.S.2. dy herë në vitin 2012 për trafikimin me qenie njerëzore dhe se B.S.2. e kishte sjellë atë në këtë situatë. Ai kurrë nuk ka kërkuar ose marrë ndonjë gjë prej tyre, por prapa shpinës së tij ishin bërë disa marrëveshje për të cilat ai nuk ishte në dijeni.
66. Kur u pyet nëse kishte ndonjë gjë që ajo dëshironte të shtonte, Prokurorja e Apelit deklaroi se sa i përket çështjes së paraburgimit, kërkesa e avokatit mbrojtës A.R., duhet të refuzohet si e pabazuar pasi që paraburgimi është i detyrueshëm nëse dënimi është mbi 5 vite.

GJETJET E GJYKATËS SË APELIT

Përbërja e Kolegjit

58. Kolegji i Gjykatës së Apelit ishte përbërë në pajtim me nenin 21 (6) të Ligjit për Gjykatat (Ligji Nr. 03 / L-199) dhe nenin 3 të Ligjit mbi Juridiksionin, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji nr. 03 / L-053) i ndryshuar me Ligjin nr. 04 / L-273 (i njohur si Ligji Omnibus).

Pranueshmëria e ankesës

59. Ankesat e avokatit mbrojtës të M.S. dhe të Prokurorit të Shtetit janë të pranueshme. Ato ishin paraqitur brenda afatit të pëcaktuar kohor nga personat e autorizuar.

Merita e rastit

Ankesa e të pandehurit dhe mbrojtësit të tij

Shkelja e nenit 384 (1.12) në lidhje me nenin 370 dhe nenin 365të KPP-së

61. Gjykata e Apelit ka vlerësuar se aktgjykimi i Gjykatës Themelore nuk i përmbush kërkesat e parapara me nenin 384 (1.12) në lidhje me nenin 370 të KPP-së.
62. Gjykata e shkallës së parë nuk ka deklaruar në mënyrë të qartë dhe në mënyrë eksplicite se cilat fakte i ka konsideruar të vërtetuara ose të pavërtetuara dhe as bazat për gjetjet e saj nuk janë paraqitur. Aktgjykimi i ankimuar nuk përmban vlerësim të besueshmërisë së provave kontradiktore, pasi që ai përmban vetëm një përmbledhje të dëshmive të dhëna nga dëshmitarët gjatë shqyrtimit gjyqësor. Nuk ka asnjë justifikim pse disa propozime të provave ishin refuzuar

nga Trupi Gjykses. Gjykata nuk e ka paraqitur arsyetimin ligjor, në veçanti gjatë përcaktimit të ekzistimit të veprave penale që iu kishin atribuar të pandehurve.

63. Dispozitivi i aktgjykimit me shkrim ndryshon shumë nga ai i shpallur më 6 tetor 2017 dhe është gjithashtu në kundërshtim me pjesën e mëvonshme të aktgjykimit. Ai tregon se të dy të pandehurit janë shpallur fajtorë për të gjitha akuzat, ndërsa Gjykata shpalli se M.S. ishte shpallur fajtor për pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 dhe u lirua nga pikat 4, 5 dhe 8. E njëjta mospërputhje vlen edhe për V.T. i cili ishte liruar nga pikat 4 dhe 5, por dispozitivi i aktgjykimit me shkrim tregon se ai u shpall fajtor për to.

64. Përveç kësaj, Gjykata nuk ka paraqitur rrethanat që i ka marr parasysh gjatë përcaktimit të dënimit.

65. Gjykata e Apelit konstaton se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ka vlerësuar provat e siguruar nga prokuroria veçmas nga provat e tjera. Duke vepruar kështu, ai ka zgjedhur artificialisht provat inkriminuese kundër të pandehurit M.S., duke shkelur parimet themelore të procedurës penale, siç është supozimi i pafajësisë dhe e drejta për gjykim të drejtë. Gjykata vëren se vlerësimi i pasaktë i provave nga gjykata, dhe veçanërisht kur provat e tilla kanë të bëjnë me elementet thelbësore të rastit, mund të çojnë në një përcaktim të padrejtë të fakteve në rastin konkret. Gjykata e Apelit nuk pretendon që të shterojë të gjitha kontradiktat dhe lëshimet në aktgjykimin e gjykatës më të ulët.

66. Duke marrë parasysh ato që u thanë më lart, Gjykata e Apelit, me shumicën e saj, konstaton se ka shkelje të konsiderueshme të dispozitave të procedurës penale dhe të cilat nuk mund të korrigjohen me ndryshimin e aktgjykimit nga Gjykata e Apelit gjatë procedurës para saj.

Shkelja e të drejtave të mbrojtjes

67. Mbrojtja e M.S. argumentoi se të drejtat e të pandehurit ishin shkelur për shkak të përjashtimit të pajustificuar të mbrojtësit të mëparshëm. Si pasojë, mbrojtësi i ri u emërua *sipas detyrës zyrtare*.

68. Aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban arsyetim se pse Gjykata ka vendosur që ta përjashtojë mbrojtësin e mëparshëm të M.S., avokatin A.I. Nga procesverbalet e seancave të shqyrtimit gjyqësor të mbajtura më 30 shtator dhe 28 tetor 2014, Gjykata e Apelit konkludon se Gjykata Themelore vendosi të përjashtojë avokatin Avni Ibrahim (si dhe mbrojtësin e B.S.1 - avokatin

R.A.2.) sepse të dy avokatët është dashur të jenë dëgjuar në këtë rast në cilësinë e dëshmitarëve. Për të mbështetur vendimin e tij, Kryetari i Trupit Gjykses iu referua nenit 56 (2) të KPP-së.

69. E drejta e mbrojtjes është një nga elementët më të rëndësishme të së drejtës për një gjykim të drejtë. Ajo mund të kufizohet vetëm në situata shumë specifike, qartazi të përcaktuara nga ligji.

70. Neni 56 i KPP-së përcakton rastet kur një person nuk mund të jetë mbrojtës në një rast specifik. Paragrafi 2 i këtij neni, i cili është zbatuar nga kryetari i trupit gjykses gjatë marrjes së vendimit për përjashtimin e mbrojtësit të emëruar nga M.S., parasheh që çdo person i cili është thirrur në shqyrtim gjyqësor si dëshmitar në parim nuk mund të jetë mbrojtës. Ekzistojnë dy përjashtime në këtë rregull të përgjithshme:

- mbrojtësi është liruar nga detyra për të dëshmuar si dëshmitar dhe ka deklaruar se nuk do të dëshmojë si dëshmitar;
- mbrojtësi është marrë në pyetje për atë që i pandehuri ia ka besuar atij në cilësi të mbrojtësit të vet, përveç kur kërkon vetëi pandehuri (neni 126 (1.2) i KPP-së).

71. Një analizë e dispozitës çon në dy skenarë potencialë. Në të parën, pikënisja është se fillimisht një person është propozuar të jetë dëshmitar në këtë rast dhe vetëm atëherë një i pandehur e konsideron të emërojë atë si mbrojtës. Në një situatë të tillë, emërimi do të jetë i mundur pasi që personi të lirohet nga detyra për të dëshmuar dhe ka deklaruar se ai ose ajo nuk do të dëshmojë.

72. Skenari i dytë parasheh që vetëm pas një pëlqimi të qartë të të pandehurit, avokati i tij mbrojtës mund të dëgjohet si dëshmitar, por dëshmia e tij duhet të kufizohet në çështjet që i janë besuar atij ose asaj nga i pandehuri.

73. Nga analiza e rrethanave të çështjes vihet në përfundim se asnjëra nga rrethanat e mësipërme nuk kanë ekzistuar në këtë rast. A.I., mbrojtësi i mëparshëm i të pandehurit M.S., u thirr si dëshmitar *ex officio* nga trupi gjykses gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor. Ai u dëgjua lidhur me rrethanat që nuk bien në kuadër të dispozitës së nenit 126 (1.2) të KPP-së, dhe i pandehuri nuk e ka dhënë pëlqimin e tij për këtë.

74. Prandaj, Gjykata e Apelit konstaton se Gjykata Themelore ka shkelur dispozitat e neneve 56 (2) dhe 126 (1.2) të KPP-së me përjashtimin e paligjshëm të mbrojtësit dhe duke e dëgjuar atë në cilësinë e dëshmitarit. Megjithatë, kjo shkelje nuk ka ndikuar në nxjerrjen e një aktgjykimi të ligjshëm dhe të drejtë, sepse kishte ndodhur në fillim të gjykimit. Avokati i përjashtuar u zëvendësua nga një tjetër që në mënyrë efektive i ka kryer detyrat e tij si mbrojtës.

Shkelja e ligjit penal

75. Gjykata e Apelit pajtohet me mbrojtësin e të pandehurit M.S. se Gjykata Themelore ka shkelur ligjin penal duke zbatuar dispozitat e kodeve penale të vlefshme në Kosovë: Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës i datës 6 prill 2004, dhe Kodi Penal i Republikës së Kosovës i datës 20 prill 2012.
76. Kur vendoset në çështjet penale, gjykata gjithmonë duhet të marrë parasysh parimet e përgjithshme të ligjit të parashikuara në nenet 2 dhe 3 të Kodit Penal. E para, është parimi i ligjshmërisë (*Nullumcrimen, nulla poena sine lege*), dhe i dyti - zbatimi i ligjit më të favorshëm.
77. Siç rezulton nga neni 3 (1) i KPK-së, në parim, ndaj kryesit zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale. Megjithatë, në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm (paragrafi 2).
78. Prandaj, në rast të ndryshimeve në ligjin në fuqi, pikënisja e analizës së gjykatës duhet të jetë që të zbulojë nëse një veprim në fjalë përbën një vepër penale sipas çdo ligji që ka qenë në fuqi që nga momenti kur veprimi ishte kryer deri sa është marrë një vendim gjyqësor i formës së prerë. Nëse ndodh që ka pasur edhe një periudhë të shkurtër kohore të dekriminalizimit të një sjellje specifike, atëherë zgjidhja e vetme është që i pandehuri të lirohet.
79. Duke vendosur që sjellja specifike përbën një vepër penale sipas ligjit në fuqi, gjykata duhet të gjejë se cili ligj është më i favorshëm për kryesin. Një vlerësim i tillë nuk mund të kryhet në mënyrë abstrakte ajo duhet të bëhet në mënyrë konkrete, në lidhje me rrethanat specifike të secilit rast dhe me veçoritë individuale të të pandehurit. Në praktikë do të thotë që Gjykata të shqyrtojë se cilat sanksione do të vendosen sipas të dy kodeve, dhe më pas të krahasohen rezultatet. Kur Gjykata vendos se cili ligj është më i favorshëm, vetëm kjo do të shënohet në kualifikimin e veprës penale dhe si bazë për dënim. Zbatimi i dy kualifikimeve ligjore nga dy kode të ndryshme për të njëjtën vepër penale nuk është praktikë e përshtatshme.
80. Gjykata e Apelit e sheh të nevojshme të theksojë se ekziston një ndryshim i rëndësishëm në sanksionet e përcaktuara nga të dy Kodet në lidhje me veprën penale të Keqpërdorimit të Pozitës Zyrtare, sepse neni 339 i KPPK-së parasheh tri sanksione varësisht nga elementet e veprës penale (deri në një vit, deri në tre vjet, dhe një deri në tetë vjet), ndërsa neni 422 i KPK-së parasheh dënimin me burg prej gjashtë muajve deri në pesë vjet. E njëjta vlen edhe për veprën penale të marrjes së ryshfetit, ku dënimi më i ashpër i parashikuar nga Kodi i mëparshëm është pesë vjet

(neni 343 (2) i KPPK-së), kurse sipas Kodit të tanishëm dënimi më i ashpër është dymbëdhjetë vjet burgim (neni 428 (2) i KPPK-së).

81. Përveç kësaj, Kodi i tanishëm Penal parasheh dënimin e veprës penale në vazhdim, ndërkohë që kjo nuk është paraparë me Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës, dhe zbatimi i të cilës në raste të veçanta mund të çojë në rezultate më të favorshme për të pandehurin (neni 81 i KPP-së). Në raste të tilla dënimi vendoset vetëm për një vepër penale në vazhdim, e cila përbëhet nga disa vepra të njëjta ose të ngjashme të kryera në një periudhë të caktuar kohore, kur plotësohen të paktën dy kushte të parashikuara në ligj (identiteti i viktimës, objekti i njëjtë; shfrytëzimi i situates së njëjtë ose marrëdhënia e njëjtë kohore; i njëjti vend ose hapësirë e kryerjes së veprës penale, i njëjti qëllim i kryesit).

Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike

82. Gjykata e Apelit pajtohet me mbrojtësin se Gjykata Themelore ka vërtetuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë gjendjen faktike, megjithatë ky vlerësim vjen nga arsye të ndryshme nga ato të përmendura në ankesën e M.S.
83. Mbrojtësi ka të drejtë kur i konteston gjetjet faktike lidhur me përfshirjen e pretenduar të M.S. në procesin e nxitjes së familjes S. në dhënien e të hollave B.S.1. në këmbim të ndikimit të favorshëm në rrjedhën e procedurës penale kundër B.S.2. Baza për një përcaktim të tillë të situatës ishin dëshmitë e anëtarëve të familjes S., të cilët ishin të interesuar drejtpërsëdrejti në rezultatin e çështjes. Aktgjykimi duket të jetë mjaft i qartë se rolin kryesor në këtë veprimtari kriminale e ka luajtur B.S.1, i bashkëpandehur, i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor ka lidhur një marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe është dënuar për veprat e tij penale me një aktgjykim të formës së prerë, lëshuar në procedurat e ndara nga ky rast.
84. B.S.1. nuk u dëgjua në cilësinë e dëshmitarit. Asnjëra nga palët nuk ka propozuar që ta dëgjojmë atë, e as nuk ishte thirrur *ex officio* nga Gjykata, pavarësisht nga fakti se në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë e cila ishte lidhur me Prokurorinë ai kishte deklaruar se do ta "ndihmojë Gjykatën dhe Prokurorinë në vërtetimin e fakteve dhe rrethanave të vërteta përreth veprës së të cilës ai tani e pranon fajin; si rezultat i kësaj, i pandehuri tregon qëndrimin e tij të hapur dhe të sinqertë në vërtetimin e së vërtetës gjatë procedurave gjyqësore "(pika 9 e marrëveshjes për pranimin e fajësisë e datës 21 prill 2015). Nga ana tjetër, Prokurori në fjalën e tij përmbyllëse e përdori marrëveshjen për pranimin e fajësisë të B.S.1. si argument për të mbështetur rastin e tij se M.S. ishte gjithashtu i përfshirë në këtë veprimtari kriminale.

85. Gjykata e Apelit, duke respektuar detyrën për të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë faktet që janë të rëndësishme për marrjen e një vendimi të ligjshëm, e konsideron të nevojshme ta dëgjojë B.S.1. në cilësinë e dëshmitarit. Dëshmia e tij është e nevojshme për të përcaktuar nëse M.S. ka qenë i përfshirë me të vërtetë në veprat penale të kryera në dëm të familjes S. në lidhje me procedurën penale kundër B.S.2.
86. Aktgjykimi nuk flet për arsyet pse gjykata e shkallës së parë nuk e ka marrë parasysh që ta thërras B.S.1. si dëshmitar në këtë rast. Vetëm në faqen e tij nr. 199 thuhet se "prokurori ka marrë deklarin nga i pandehuri, B.S.1. në lidhje me pikat e aktakuzës për të cilat ai është si një i bashkë-akuzuar së bashku me të pandehurin, M.S. (d.m.th. pikat 1, 2 dhe 3). Megjithatë, trupi gjykues vendosi që këto deklarime, të cilat ishin bërë gjersa shqyrtimi gjyqësor ishte në vazhdim, e kanë ngritur të pandehurin B.S.1 në statusin e një dëshmitari bashkëpunues dhe kjo ishte jashtë fushëveprimit të një marrëveshjeje për pranimin e fajësisë në atë fazë të procedurës, prandaj deklarinet nuk mund të konsiderohen si provë. "Nuk ka asnjë arsye ligjore përse Gjykata Themelore ka vendosur në këtë mënyrë. As në procesverbalin e seancës kur ishte arritur marrëveshja e tij mbi pranimin e fajësisë nuk gjendet ndonjë arsye.
87. Gjatë seancës para Gjykatës së Apelit, Prokurorja e Apelit nuk ishte në gjendje t'i përgjigjej pyetjes nëse prokuroria kishte për qëllim të thërriste B.S.1. si dëshmitar, sepse padyshim ajo nuk ishte e përfshirë në procedurat para gjykatës së shkallës së parë. Më vonë, ajo e ofroi këtë informacion, i cili i ishte dërguar mbrojtësit të M.S., ku ajo shpjegoi rrjedhën e procedurave në lidhje me marrjen e mundshme në pyetje të B.S.1. Sipas kujtesës së Prokurorit të PSRK-së, pas kontrollimit të informacionit në dispozicion në dosje, nuk është bërë asnjë kërkesë (zyrtare) për ta shpallur B.S.1. dëshmitar bashkëpunues. Prokurori i PSRK-së tregoi dëshirën e tij për t'a shfrytëzuar B.S.1. si dëshmitar, pa një marrëveshje bashkëpunimi, megjithatë, kryetari i trupit gjykues i Gjykatës Themelore ka deklaruar se Gjykata nuk do të lejojë atë. Gjatë vendosjes lidhur me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë të B.S.1., Gjykata Themelore nuk u pajtua për ta bërë bashkëpunimin e B.S.1. një kusht të marrëveshjes, ashtu si dëshiroi prokurori i PSRK-së. Gjykata këmbënguli që kjo pjesë duhet të largohet nga marrëveshja dhe të trajtohet më vonë. Megjithatë, gjatë procedurës u bë e qartë se Gjykata nuk do të lejonte Prokurorinë që ta thërrasë B.S.1., sepse Gjykata e kuptoi se B.S.1. si i tillë nuk mund të thirrej si dëshmitar në bazë të KPPK-së, pasi që ai nuk i kishte plotësuar kërkesat për të qenë dëshmitar bashkëpunues. Gjykata është e bindur se Prokuroria ishte përpjekur që ta thërrasë B.S.1. si dëshmitar bashkëpunues, pavarësisht nga fakti se Prokuroria nuk

e ka pasur atë qëllim. Prokuroria e kishte deklarimin e B.S.1. lidhur me atë që ai dinte në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe në shtojcën për pranimin e fajësisë, por kjo nuk ishte e pranueshme në gjykim. Prandaj B.S.1. (përveç marrëveshjes së tij) nuk u bë një çështje dhe nuk u thirr e as nuk u tentua që të thirret si dëshmitar bashkëpunues.

88. Nga ky informacion rezulton se Gjykata Themelore ka konstatuar se nuk është e mundur që të dëgjohet B.S.1. si dëshmitar në rastin kundër M.S. Gjykata e Apelit nuk pajtohet me një interpretim të tillë të dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Penale dhe mendon se dëshmia e B.S.1., pasi ai u shpall fajtor, duket të jetë një nga provat më të rëndësishme në këtë rast. Si rezultat i marrëveshjes së tij për pranimin e fajësisë, e cila vërtetohet edhe nga dëshmitë e anëtarëve të familjes S., ai ishte një person i rëndësishëm me të cilin ata kishin kontakt, biseduan për rezultatin e mundshëm të rastit, dhanë para dhe bënë marrëveshje. Ata gjithashtu u siguruan nga B.S.1. se ai do të bisedonte me M.S. dhe do ta përfshijë atë në përpjekjen për të ndihmuar B.S.2. që të lirohet nga paraburgimi ose për të ndikuar në një mënyrë tjetër gjatë rrjedhës së procedurave kundër tij.
89. Nuk ka pengesa ligjore për ta dëgjuar B.S.1. si dëshmitar. Ai nuk ishte më dëshmitar i privilegjuar i cili nuk mund të merrej në pyetje sepse pasi që çështja e tij u nda ai pushoi së qenuri i pandehur në procedurat e përbashkëta me M.S. (neni 126 (1.3) i KPP-së). Përveç kësaj, një interpretim i tillë është i mbështetur edhe nga neni 338 (1) i KPP-së i cili lejon leximin e procesverbaleve që përmbajnë dëshminë e bashkë - të akuzuarit i cili tashmë është dënuar.
90. Është e vërtetë që në këtë fazë të procedurës, B.S.1. nuk mund të ishte shpallur dëshmitar bashkëpunues. Një mundësi e tillë u përjashtua sepse sipas nenit 235 (1) të KPP-së ky status mund t'i jepet vetëm një të dyshuari ose të pandehuri për të cilin aktakuza ende nuk është lexuar. Në këtë rast, aktakuza kundër B.S.1. u lexua tashmë në vitin 2014, ndërsa ai hyri në marrëveshjen e pranimit të fajësisë në vitin 2015.

Ankesa e prokurorit të PSRK-së

Shkelja e ligjit penal (Pikat 4 dhe 8)

91. Gjykata e Apelit pajtohet me parashtresën e Prokurorit se Gjykata Themelore shkeli ligjin penal gjatë marrjes së vendimit për pikën 4 të Aktakuzës (Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore) kur arriti në përfundimin se formulimi në gjuhën angleze i nenit 318 (1) të KPK është kaq i dykuptimshëm saqë nuk mund të përbëjë ndonjë vepër penale.

92. Kushtetuta e Kosovës në nenin 5 (1) parasheh që gjuhët zyrtare në territor janë gjuha shqipe dhe gjuha serbe. Asnjëra prej tyre nuk mbizotëron ndaj njëra-tjetrës në rast të mospërputhjes. Në bazë të nenit 16 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX në Kosovë, gjuha zyrtare në procedurat në të cilin gjyqtarët dhe prokurorët EULEX janë të përfshirë, është edhe gjuha angleze.

93. Kjo është e vërtetë që përkthimi anglisht i nenit 318 (1) të KPK-së, i përdorur nga gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it, nuk është i qartë, siç përcakton:

Kushdo që me qëllim që vetes apo personit tjetër t'i mundësojë shmangien nga pagesa e tarifave tatimore doganore apo tarifave tjera ose detyrimeve doganore që paguhen me rastin e importimit apo eksportimit të mallrave, ose nëse doganës i paraqet dokument të rrejshëm lidhur me prejardhjen, vlerën, sasinë, cilësinë, llojin apo karakteristikat tjera të mallit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Sidoqoftë, në një situatë të tillë ishte detyrë e Kryetarit të trupit gjykues që ti referohej versioneve origjinale të gjuhës (shqip dhe serbe) dhe të marrë një përkthim të duhur të dispozitës në fjalë. Kjo është bërë nga gjyqtari raportues i Gjykatës së Apelit dhe neni 318 (1) i KPK-së është përkthyer përsëri nga të dyja gjuhët në gjuhën angleze si vijon:

Kushdo që me qëllim që vetes apo personit tjetër t'i mundësojë shmangien nga pagesa e tarifave tatimore doganore apo tarifave tjera ose detyrimeve doganore që paguhen me rastin e importimit apo eksportimit të mallrave, ose nëse doganës i paraqet dokument të rrejshëm lidhur me prejardhjen, vlerën, sasinë, cilësinë, llojin apo karakteristikat tjera të mallit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

94. Elementet e veprës penale të përcaktuara në nenin 318 (1) të KPK-së janë si në vijim:

- vepruar me qëllim që vetes apo personit tjetër, dhe si rezultat
 - mundësimin e shmangies nga pagesa e tarifave tatimore doganore apo tarifave tjera ose detyrimeve doganore që paguhen me rastin e importimit apo eksportimit të mallrave;
- ose
- ose nëse doganës i paraqet dokument të rrejshëm lidhur me prejardhjen, vlerën, sasinë, cilësinë, llojin apo karakteristikat tjera të mallit.

95. Prandaj, vendimi i Gjykatës Themelore për të liruar të pandehurit M.S. dhe V.T. nga pika e shmangies së pagesës së tarifave tatimore doganore për shkak të paqartësisë së formulimit në gjuhën angleze të kësaj dispozite nuk ishte i justifikuar. Megjithatë, gjatë rigjykimit, gjykata e shkallës së parë duhet të vendosë nëse sjellja e të pandehurve siç është paraqitur nga prokurori në aktakuzë i përmbush elementet e kësaj veprë penale. Për të vendosur lidhur me të, gjykata duhet t'i referohet jo vetëm Kodit Penal, por gjithashtu duhet të jetë e obliguar që të analizojë dispozitat përkatëse të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës.
96. Prokurori gjithashtu ka të drejtë kur ngrit shkeljen e Kodit Penal në lidhje me Pikën 8 (mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të armëve, në kundërshtim me nenin 374 (1), në lidhje me nenin 120, pika 38, të KPK-së 2013) . Gjykata Themelore e liroi të pandehurin M.S. për shkak të ekzistencës së rrethanës që përjashtonte përgjegjësinë, domethënë se kjo veprë penale është e mbuluar nga Ligji për Amnistinë (nr. 04 / L-209).
97. Një interpretim i tillë i ligjit përbën shkelje të ligjit penal. Neni 1 i Ligjit për amnistinë është i qartë – ai zbatohet vetëm për vepra penale të cilat janë kryer para datës 20 qershor 2013. I pandehuri M.S. është i akuzuar për posedim të armëve i cili dyshohet se ka ndodhur më 11 shtator 2013, pra pas afatit për të cilin amnistia do të mund të lejohej.
98. Gjykata e Apelit gjithashtu pajtohet me prokurorin kur ai theksoi se nuk është e rëndësishme për ekzistencën e kësaj veprë penale nëse arma është përdorur ose nëse ka shkaktuar ndonjë rrezik apo jo. Këto rrethana mund të jenë relevante si faktorë gjatë marrjes së vendimit mbi ndëshkimin pasi është konstatuar se i pandehuri ka kryer një veprë penale. Ato gjithashtu mund të kenë ndikim në vlerësimin nëse vepra penale mund të konsiderohet si një veprim me rëndësi të vogël (neni 11 i KPK).

Vërtetimi i gabueshëm ose jo i plotë i gjendjes faktike (Pika 5)

99. Gjykata e Apelit pajtohet me argumentet e Prokurorit se Gjykata Themelore nuk e ka vërtetuar në tërësi gjendjen faktike në lidhje me pikën 5. Në këtë kontekst, duhet të theksohet se nga aktgjykimi rrjedh se Gjykata nuk ka vlerësuar me vetëdije çdo provë, dhe në lidhje me sendet e tjera të provave. Një përfundim i tillë rezulton nga fakti se vetëm një pjesë e bisedës telefonike e përgjuar në mes të pandehurit M.S. dhe V.T. është analizuar, ndërsa elementet e saj përkatëse, të paraqitura në *extenso* nga Prokurori në ankesën e tij, janë lënë jashtë.

100. Prandaj, gjatë rigjykimit Gjykata Themelore do t'i dëgjojë sërish dëshmitarët dhe do të analizojë të gjitha pjesët e provave të pranueshme në lidhje me këtë pikë.
101. Gjatë seancës para Gjykatës së Apelit, Prokurori kërkoi që pika 5 të ri-cilësohet si keqpërdorim i pozitës zyrtare në kundërshtim me nenin 422 të KPK-së.
102. Gjykata Themelore do të duhet të analizojë rrethanat e ngjarjes që ishin bazë e Pikës 5 të aktakuzës, duke respektuar parimin se aktgjykimi mund të lidhet vetëm me aktin që është subjekt i kësaj akuze (neni 360 (2) i KPP-së). Megjithatë, duhet të mbahet mend se i mbetet gjykatës të vendosë për cilësimin ligjor të veprës penale që i atribuohet të pandehurit. Gjatë rigjykimit, Gjykata Themelore do të obligohet të shqyrtojë nëse sjellja e të pandehurit M.S., në lidhje me ngjarjen me pjesëmarrjen e V.T., përbën veprën penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare.

Përcaktimi i sanksionit penal

103. Rasti është dërguar për rigjykim, megjithatë Gjykata e Apelit e sheh të nevojshme që të adresojë kërkesën e Prokurorit në lidhje me përcaktimin e sanksionit penal. Pyetja është se si të përcaktohet ndëshkimi plotësues i ndalimit të ushtrimit të funksioneve në shërbimin publik. Është e një rëndësie të veçantë në këtë rast, ku i njëjti trup gjykues ka paraqitur dy qasje të ndryshme për këtë çështje, sepse në rastin e B.S.1. u vendos një ndalim 20-vjeçar, ndërsa në rastin e M.S. gjykata e pa të nevojshme ta shqiptojë këtë masë vetëm për 5 vjet.
104. Siç rezulton nga neni 65 (1) i KPK-së, gjykata e ndalon kryesin nga ushtrimi i funksioneve në administratën publike ose shërbimin publik për një deri në pesë vjet pasi që të jetë vuajtur dënimi me burgim, nëse ky person ka keqpërdorur këto funksione dhe është dënuar për to. Në rastin e dënimit për vepra penale të njëkohshme, neni 80 (3) i KPK-së parasheh që gjykata të shqiptojë dënim plotësues nëse ka shqiptuar për të paktën një nga veprat penale, në përputhje me nenin 80 (2.4) të KPK-së. Kjo dispozitë e fundit rregullon mënyrën e dënimit në një rast kur gjykata ka shqiptuar dënim me gjobë për secilën vepër penale. Në një situatë të tillë dënimi unik i një gjobe është shuma e përgjithshme e të gjitha gjobave, por nuk mund të tejkalojë shumën prej 25.000 euro, ose 500.000 euro në rastin kur një ose më shumë vepra penale kryhen me synimin për të përfituar një dobi pasurore. Një dispozitë e ngjashme e përfshirë në Kodin e mëparshëm duket të jetë më pak e saktë, sepse neni i saj 71 (2.4), i zbatueshëm edhe për dënimet plotësuese, përcakton që në situata të tilla dënimi unik me gjobë nuk mund të tejkalojë shumën prej 25.000 euro ose 500.000 euro në rast se një ose më shumë vepra penale janë kryer me qëllim të

përfitimit të një dobie pasurore. Megjithatë, dispozita nuk përmendi "shumën totale të të gjitha gjobave".

105. Të dy kodet japin të njëjtat kufizime për gjobat - 25.000 euro ose 500.000 euro në rast kur një ose më shumë vepra penale janë kryer me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore (neni 39 (1) i KPPK-së dhe neni 46 (1) i KPK-së). Pra, është e qartë se dënimi unik i një gjobe nuk mund të tejkalojë maksimumin e parashikuar me ligj për një gjobë si një dënim kryesor.
106. Prandaj, Gjykata e Apelit nuk pajtohet me parashtresën e prokurorit se nuk ka asgjë në ligj që ndalon dënimin unik plotësues në kohëzgjatjen e shumës totale të të gjitha periudhave të vendosura. Periudha e dënimit të përgjithshëm plotësues i ndalimit të ushtrimit të funksioneve në shërbimin publik është shuma totale e të gjitha periudhave të shqiptuara, por ajo nuk mund të kalojë kufijtë ligjor të parashikuar për këtë masë (5 vjet në përputhje me nenin 65 (1) të KPK-së).

Përfundim

107. Gjatë rigjykimit, Gjykata Themelore duhet të dëgjojë B.S.1. si dëshmitar dhe të përsërisë marrjen në pyetje të shumicës së dëshmitarëve relevant të cilat kanë dëshmuar gjatë gjykimit të parë (B.S.2., X.B., K.S., A.S., S.S., H.B., B.S.4., H.S., A.X., D.X., V.S., Z.N., N.S. dhe S.O.). Në rastin e dëshmitarëve tjerë, Gjykata Themelore mund të vendos që t'i lexojë deklaratat e mëparshme apo t'i konsiderojë ato si të lexuara. Nëse është e nevojshme, mund të paraqiten edhe fakte dhe prova të reja. Gjykata Themelore duhet t'i shqyrtojë pikat kontestuese të cekura në vendimin e Gjykatës së Apelit.
- 10.8 Duke marrë parasysh atë që u tha më lart, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv.

E përpiluar në gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar. Aktgjykimi i arsyetuar i përfunduar më 14.11.2017.

Kryetari i trupit gjykues

Driton Muharremi

Gjyqtar i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjyqtarja Raportues

Anëtari i Kolegjit

Anna Adamska-Gallant

Abdullah Ahmeti

Gjyqtare e EULEX-it (*mospajtuese*)

Gjyqtar i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Procesmbajtësja

Kerry Moyes

Zyrtare Ligjore e EULEX-it

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS

PAKR 77/2017